



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
INSPEKTORATI QENDROR

**URDHËR**

Nr. 32/1, datë 15/04/2016

**Për**

**Disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin Nr. 32, datë 29.04.2014,  
“Për miratimin e modelit të kartës së inspektorit”.**

Në zbatim të nenit 30, pika 4, të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Në modelin e kartës së inspektorit, të miratuar me Urdhrin Nr. 32, datë 29.04.2014, të bëhen edhe këto shtesa e ndryshime:
  - Në pjesën e përparme të kartës së inspektorit, të ndryshohen:
    - Stema e Republikës (në mes të kartës)
    - REPUBLIKA E SHQIPËRISË (në mes të kartës)
    - Emri i inspektoratit shtetëror (në mes të kartës)
  - Në pjesën e prapme të kartës së inspektorit, të shtohet:
    - Emër, Mbiemër i Inspektorit të Përgjithshëm;
    - Nënshkrimi i Inspektorit të Përgjithshëm;
    - Vula e institucionit.
2. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore/Trupat e tjera Inspektuese, për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare, publikohet në Faqen Zyrtare të Inspektoratit Qendror, [www.inspektoratiqendror.gov.al](http://www.inspektoratiqendror.gov.al), dhe i njoftohet Inspektorateve Shtetërore/Trupave Inspektuese.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



**INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM**

**SHKËLQIM HAJDARI**




## KARTA INSPEKTOR

(Pjesa Para)

 REPUBLIKA E SHqipërisë EMRI INSPEKTORATIT SHITËTËROR	
<b>KARTË INSPEKTORI</b>	
Emër Mbiemër: Xxxxx XXXXXX	
Pozicioni: Inspektor i punës	
Kodi: 00001	
Data e lëshimit: xx.xx.2016	

(Pjesa Mbrapa)

 INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM Shkëlqim HAJDARI	<p>Firma _____</p> <p><i>Vula IO</i></p>
Kjo kartë mund të përdoret vetëm nga mbajtësi i saj. Në rast humbjeje ose moskthimi mbajtësi, lutemi dërgoni kartën pranë Inspektoratit Qendror.	
<p><a href="mailto:info@insp.gov.al">info@insp.gov.al</a> <a href="http://www.inspektoratqendror.gov.al">www.inspektoratqendror.gov.al</a></p>	